



Përmendja e profetit Muhamed në shkrimet e shenjta

Description

Dr. Lejla Demiri

Nuk ka asnjë dyshim se shqyrtimi i një çështjeje kaq të gjerë brenda një hapësire kaq të shkurtër përmban vështirësi objektive brenda saj. Për këtë arsye është e nevojshme që të qartësojmë limitet e këtij studimi. Së pari do të përmendim përpjekjet e dijetarëve myslimanë për të vërtetuar profetësinë e Muhamedit (a.s.) duke u mbështetur në tekstin biblik, po ashtu do të shqyrtojmë opinionet dhe mendimet e tyre në lidhje me këtë çështje. Për të parandaluar çdo dykuptimësi që mund të lindë kur e trajton një subjekt të tillë brenda strukturës së historisë së përgjithshme, të gjitha opinionet dhe qasjet e ndryshme do të përmenden duke ju referuar dokumenteve të ndryshme nga periudha klasike. Dokumenti i parë që do të marrim në shqyrtim është një tekst dialogu i përpiluar në Bagdad (në 165 h./781 e.r. ose 166 h./782 e.r.). Ky dokument është i një rëndësie të veçantë, meqenëse është një prej dokumenteve të para të cilat reflektojnë dialogun midis myslimanëve dhe të krishterëve. Ky tekst u shkrua ngapatriarku Timote dhe është i rëndësishëm sepse mbulon metodën e leximit të Biblës nga ana e myslimanëve, të përfaqësuar nga Mehdi. Punimi i dytë që do të marrim në shqyrtim është trajtesa (Risale) e Ibnu Lejs-it. Kjo vepër është shumë e rëndësishme, meqenëse është vepra më e hershmemyslimane në të cilën janë grumbulluar citime të ndryshme nga Bibla të cilat i referohet profetit Muhamed (a.s.). Kjo vepër është një letër e shkruar për Harun err-Rrashidin (i cili mbretëroi midis 170h./786 e.r.- 193 h./ 809) gjatë vitit 795 ose 796 e.r. dhe i ishte dërguar perandorit bizantin Kostandini i VI (780-797 e.r.). Vepra e tretë të cilën do ta marrim në shqyrtim është punimi imirënjohur i titulluar “Kitab ed-din ve delve”, shkruar në një periudhë e cila është shumë e afërt me kohën e dy veprave të para. Kjo vepër është shkruar nga Ali bin Rabban el-Tabari (240h/855e.r.) i cilinga i krishterë u konvertua në Islam. Elementi i përbashkët në këto tre vepra gjendet në faktin se ato përmbajnë shembuj të leximeve dhe përsiatjeve që myslimanët i kishin bërë tekstit biblik për të gjetur në të pohime të cilat paralajmëronin ardhjen e profetit Muhamed (a.s.).

Kurani dhe Bibla

Në Kuran gjejmë referime të shumta ndaj besimit dhe librave të shenjtë të besuara nga të krishterët. Përgjatë historisë, shkollarët myslimanë të cilët e vendosnin Kuranin në qendër të sistemit të tyre të mendimit, duke u nisur nga struktura kuranore, vendosën një perspektivë të caktuar në lidhje me religjionet e tjera, veçanërisht për sa i përket krishterimit. Për rrjedhojë, debatet dhe argumentet teologjike që rezultuan si pasojë e takimeve ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve niseshin nga këndvështrimi kuranor dhe përfshinin argumente të bazuara në mësimet e Kuranit. Kundërshtia ndaj doktrinave të ndryshme të krishtera, të tilla si Triniteti, mishërimi i Zotit, hyjnia dhe kryqëzimi i Jezusit, të cilat përgjithësisht shiheshin si nëkundërshtim me besimin islam, si edhe çështje të tjera të cilat lidheshin në mënyrë indirekte me këndvështrimin e krishterë, paraqiten në Kuran në kontekst të dëshmi se mesazhi hyjnor ishte korruptuar dhe se referimet e Jezusit për një profet tjetër që do të vinte pas tij ishin ndryshuar përgjatë historisë shkrimeve.

Sipas këndvështrimit kuranor profetësia ishte një zinxhir i pakëputur. Mësimet e profetëve të ndryshëm nuk ishin në mospërputhje me njëri-tjetrin, përkundrazi ato konfirmonin njëri-tjetrin. P.sh. Jezus Krishti kishte konfirmuar vlefshmërinë e torahut dhe kishte përmendur profetin që do ta pasonte atë (Kuran 61:6). Zinxhiri i profetësisë ishte përmbyllur nga profeti Muhamed (a.s.), i cili ishte vula e profetëve (khatemul enbija). Ky besim nënkupton që Kurani i konfirmon mesazhet hyjnore të mëparshme, duke pohuar se edhe ato kanë burim hyjnor, dhe pranon vlefshmërinë e dispozitave të tyre. Mbi të gjitha ekzistenca e profetit Muhamed (a.s.) vërteton librat dhe profetët e mëparshëm. Mefjalë të tjera, ardhja e profetit dhe e librit të shenjtë që ju dha atij ishin mjete për konfirmimin dhe verifikimin e profetëve të mëparshëm. Pohimi i Taberit se: “Nëse nuk do të kishte ardhur profeti Muhamed (a.s.) mesazhet e profetëve të mëparshme do të kishin humbur vlefshmërinë e tyre” është një shembull i mirë për një qasje të tillë. Sipas këtij autori, “Allahu e mban premtimin e Tij dhe nuk e ndryshon mesazhin e Tij” (Kitab ed-Din ve Devle, f. 66)

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi